



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.480/2019

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Gani Avdiu anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Balkan Green Foundation (BGF), me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Zhvillimit Ekonomik në Prishtinë, me bazë juridike anulim i përgjigjes ndaj kërkesës për qasje në dokumente zyrtare, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.318/2017, të datës 10.04.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.03.2020, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Ministria e Zhvillimit Ekonomik në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.318/2017, i datës 10.04.2019, vërtetohet.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.318/2017, të datës 10.04.2019, është aprovuar si e bazuar kërkesëpapia e paditësit Balkan Green Foundation(BGF). Ndërsa është detyruar e paditura Ministria e Zhvillimit Ekonomik në Prishtinë, që brenda 30 ditëve nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi, ti lejoj paditësit Balkan Green Foundation me seli në Prishtinë, të ketë qasje në thirrjen finale për aplikim, e cila i është dërguar kompanive të para kualifikuara për ndërtimin e TC "Kosova e Re" si dhe qasje në ndryshimet në pakon tenderuese që kanë ndodhur nga thirrja e parë e kualifikimit e deri më tani, dhe arsyet për ndryshimet e tilla.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, përmes përfaqësueses së autorizuar Ministria e Drejtësisë - Avokatura Shtetërore, me të cilën e konteston ligjshmërinë e aktgjykimit të atakuar, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të



së drejtës materiale. Me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, aktgjykimin A.nr.318/2017, të datës 10.04.2019, ta prishë duke vendosur meritorisht, ashtu që ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit Balkan Green Foundation (BGF)/Konsorciumi Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:


Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka parashtruar padi për konflikt administrativ kundër të paditurës me datën 22.02.2017, me të cilin ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet si e bazuar padia e paditësit Balkan Green Foundation (BGF). Ndërsa të detyrohet e paditura Ministria e Zhvillimit Ekonomik në Prishtinë, që brenda 30 ditëve të merr aktvendim me të cilin do ti lejohet paditësit qasje në thirrjen finale për aplikim, e cila i është dërguar kompanive të parakualifikuara për ndërtimin e TC "Kosova e Re", si dhe qasje në ndryshimet në pakon tenderuese që kanë ndodhur nga thirrja e parë për kualifikim, e deri me tani dhe arsyet për ndryshime të tilla.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimit të paditurës Ministria e Zhvillimit Ekonomik në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar. Me arsyetim se gjykata vlerëson si të pabazuar pretendimin e organit të paditur i cili ka konsideruar se të dhënat e kërkuara janë akoma në formë të draftit dhe nuk janë të finalizuara, ngase dokumentet e tilla të institucioneve publike duhet të jenë të hapura për qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe nga ky aspekt ata kanë drejtpërsëdrejti interes të arsyeshëm të informohen lidhur me këtë përmbajtje.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, përgjigjës në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë iu ka referuar Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, si dhe Konventës Evropiane për Mbrojtjen e Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

Sa i përket pretendimeve ankimore, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron, me që gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar



seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPA-së dhe LKA-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata nuk i ka marrë në konsideratë provat materiale në bazë të të cilave e paditura ka sqaruar se paditësit ia ka ofruar thirrjen për kualifikim dhe kompanitë /koalicionet të cilat kanë aplikuar, ndërsa për dokumente tjera e ka njoftuar paditësin se ende janë draft dokumente, dhe si të tilla janë të pa përmbyllura dhe në proces. Prandaj, bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare, përkufizohen si konfidenciale dhe nuk mund të ndahen me palë të treta. Kolegji i kësaj gjykate konsideron se këto pretendime janë të pa bazuara dhe të paqëndrueshme, meqë gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit në padi janë të bazuara. Sepse me nenin 2 par. 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, përcaktohet se “1. Ky ligj zbatohet për të gjitha dokumentet që mbahen, hartohen apo pranohen nga institucionet publike. 2. E drejta për qasje në dokumente realizohet në pajtim me këtë ligj, pa paragjykuar dispozitat e ligjeve, si dhe të instrumenteve ligjore ndërkombëtare, të cilat njohin të drejta më të gjëra, për qasjen në dokumente publike”. Ndërsa me nenin 12 par.1 të të njëjtit ligj përcaktohet se “Çdo kërkuar ka të drejtë të ketë qasje në dokumente publike. Kufizimi i kësaj të drejte ushtrohet proporcionalisht dhe vetëm për qëllime të mbrojtjes së: 1.1. sigurisë kombëtare, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare; 1.2. sigurisë publike; 1.3. parandalimit, hulumtimit dhe ndjekjes së aktiviteteve penale; 1.4. hulumtimeve disiplinore; 1.5. inspektimit, kontrollimit dhe mbikëqyrjes nga institucionet publike; 1.6. privatësisë dhe interesave të tjerë legjitim privat; 1.7. interesave komerciale dhe të tjera ekonomike; 1.8. politikave ekonomike, monetare dhe këmbimore të shtetit; 1.9. barazisë së palëve në procedura gjyqësore dhe administrimin efikas të drejtësisë; 1.10. mjedisit, apo, 1.11. diskutimeve brenda apo ndërmjet institucioneve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështjeje”. Kurse me nenin 10 par.3 dhe 4 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, përcaktohet se “3. Me kërkesën e cilitdo person, autoriteti kontraktues i siguron qasje të menjëhershme dhe të arsyeshme personit të tillë, i cili kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste, që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3. të këtij neni, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (ii) në datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (iii) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim sipas paragrafit 2. të nenit 62 të këtij ligji ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur. 4. Autoriteti kontraktues do të sigurojë qasjen e kërkuar nga paragrafit 3. i këtij neni në mënyrë të rregullt, të qetë, dhe pa pengesa. Sidoqoftë, autoriteti kontraktues mundet që të mbikëqyrë qasjen në fjalë ose të marrë masa të arsyeshme për të ruajtur integritetin e të dhënave”. Ndërsa me dispozitën ligjore nga neni 11 par 3 të të njëjtit Ligj përcaktohet se “3. Autoriteti kontraktues mund t’i klasifikojë informatat e tjera si informatë sekrete afariste vetëm nëse informata përkatëse i përmbushë këto tri kritere: 3.1. që atë ta ketë dërguar një operator ekonomik në përputhje me kërkesën e përcaktuar nga autoriteti i tillë kontraktues sipas nenit 68 ose 69 të këtij ligji; 3.2. që operatori përkatës ekonomik t’i ketë dërguar autoritetit kontraktues kërkesën me shkrim duke shprehur dëshirën e tij që autoriteti kontraktues t’i mbajë artikujt e tillë si sekret; dhe 3.3. kërkesa e tillë me shkrim të përmbajë një deklaratë me shkrim (i) në të cilën vërtetohet se një element i tillë nuk është pronë



publike, dhe se të dhënat mbrohen nga operatori ekonomik nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia, dhe (ii) me të cilin parashtrihen arsyet, që bindshëm demonstronjë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik". Prandaj, meqë e paditura nuk ka ofruar dëshmi bindëse dhe të arsyetuara mirë në kuptim të dispozitave të lartcekura, e posaçërisht nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, se në cilën kategori të përjashtimeve të theksuara mbështetet ky kufizim, kolegji i kësaj gjykate një vlerësim të tillë të paditurës në këtë çështje nuk mund ta merr si të rregullt dhe të ligjshëm.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike të konstatuar, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga gjykata e shkallës së parë, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës nga shkaku se e paditura me asnjë provë nuk e ka vërtetuar një gjendje të tillë të krijuar për mos mundësin e lejimit të qasjes në dokumente publike. Sepse sipas nenit 41 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcaktohet se "Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike, dhe se dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë". Ndërsa sipas nenit 10 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, e cila në bazë të nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës zbatohet drejtpërsëdrejti në Kosovë, përcaktohet se "1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë. 2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor". Andaj për këto arsye gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se dokumentet e tilla të institucioneve publike duhet të jenë të hapura për qytetarët, ngase ata kanë drejtpërsëdrejti interes të arsyeshëm të informohen lidhur me këtë përmbajtje.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve tjera ankimore, se aktgjykimi i ankimuar është i kundërligjshëm, ky kolegji nuk i aprovoi sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme dhe pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, për faktin se i njëjti nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, e pasi që me pretendimet tjera



ankimore një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr.480/2019, me datë 05.03.2020

Kryetari i kolegjit  
Ramiz Kuqi

